



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.264, datë 11.10.2022

PËR

“CAKTIMIN E ZOTIT ARENS ÇELA, NËPËRMJET PROCEDURËS SË NGRITJES
NË DETYRË, NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 47 pika 6 dhe 52 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 28 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të caktojë zotin Arens Çela në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Zoti Arens Çela do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nga data 11.10.2022 deri më datë 10.10.2025.
3. Të ndërpritet caktimi i përkohshëm i zotit Arens Çela si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Arens Çela, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 11.10.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazarj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurrihan Seiti

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirëla Bogdani